



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 174

Tiranë – E enjte, 19 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 146/2019, datë 18.12.2019	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 84/2017, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar..... 13227
Vendim i Kuvendit nr. 147/2019, datë 18.12.2019	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin..... 13227
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 16.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar të miturës Klejsa Greku..... 13227
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 16.12.2019	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës nr. 914, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 13228
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 18.12.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 13230
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 18.12.2019	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë 14/86, zona kadastrale 8571, dhe nga Ministria e Drejtësisë te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të pasurisë 16/51-8, zona kadastrale 8571, Njësia Administrative Lushnjë, dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 16.6.2005, të ndryshuar, dhe nr. 818, datë 6.12.2006, të ndryshuar..... 13230

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 18.12.2019	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Korçë, të pronës nr. 545, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	13234
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 819, datë 18.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me përfaqësues në shtabin “Eufor”, në kuadër të operacionit ushtarak “Althea” të Bashkimit Evropian në Bosnjë-Hercegovinë”, të ndryshuar.....	13235
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 820, datë 18.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 910, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar Kfor, Kosovë”, të ndryshuar.....	13235
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 18.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 911, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin “RSM”, në shtabe të ndryshme të NATO-s, në Afganistan”, të ndryshuar.....	13236
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 18.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 912, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin “RSM” të NATO-s, pranë Komandës së Batalionit Shumëkombësh, në Afganistan”, të ndryshuar.....	13236
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 18.12.2019	Për procedurën e blerjes së banesave në tregun e lirë, që i shtohen fondit publik të banesave sociale me qira.....	13237
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 825, datë 18.12.2019	Për subvencionimin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.....	13242
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 18.12.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Komuna e Parisit–Rrugë e Re Tiranë–Elbasan” (shtesa).....	13242
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 18.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 489, datë 19.7.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe nënstacionit 110 kV Himarë”.....	13244
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 830, datë 18.12.2019	Për miratimin e rregullave të hollësishme për grumbullimin, ambalazhimin, transportin, ruajtjen, etiketimin, njoftimin e aktivitetit dhe kontrollin e produkteve biologjike”	13245
Vendim i Komitetit Ndërmintor i Emergjencave Civile nr. 6, datë 16.12.2019	Për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga tërmeti i datës 26 nëntor.....	13259
Vendim i Komitetit Ndërmintor i Emergjencave Civile, nr. 7, datë 18.12.2019	Për përcaktimin e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së mallrave, ndihmë humanitare, dhuruar nga donatorë të huaj me destinacion të përcaktuar të një komuniteti.....	13259

**VENDIM
Nr. 146/2019****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 84/2017, “PËR
MIRATIMIN E PËRBËRJES DHE
PROGRAMIT POLITIK TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës,
mbështetur në dekretin nr. 11386, datë 13.12.2019,
të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit të Kuvendit nr.
84/2017, datë 13.9.2017, “Për miratimin e
përbërjes dhe programit politik të Këshillit të
Ministrave”, të ndryshuar, pas pikës 16, shtohet
pika 17, me këtë përmbajtje:

“17. Zoti Arben Ahmetaj Ministër Shteti për
Rindërtimin”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 18.12.2019

**VENDIM
Nr. 147/2019****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E MINISTRIT TË SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës,
mbështetur në dekretin nr. 11387, datë 13.12.2019,
të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës
nr. 11387, datë 13.12.2019, për emërimin e zotit

Arben Ahmetaj në detyrën e Ministrit të Shtetit për
Rindërtimin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 18.12.2019

**VENDIM
Nr. 812, datë 16.12.2019****PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR TË MITURËS
KLEJSA GREKU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe
të nenit 5/1/a, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993,
“Për sigurimet shoqërore në Republikën e
Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e
Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar,
mujor, të miturës Klejsa Greku, për periudhën deri
në mbushjen e moshës 18 vjeç, në masën e dyfishit
të pensionit social, të miraturar sipas ligjit nr. 7703,
datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore
për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në
Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1
nëntor 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 813, datë 16.12.2019**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË
SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA
E MBROJTJES TE MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
TË PRONËS NR.914, ME EMËRTIM
“AERODROM FUSHOR”, ME
VENDNDODHJE NË VLORË, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës nr. 914, me

emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për infrastrukturë aeroportuale, për ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA).


2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shetëtorë, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shetëtorë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet prona nr. 914, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shetëtorë, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shetëtorë e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**





VENDIM

Nr. 816, datë 18.12.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet shteti “Kinë, Republika Popullore*”, me dokumentin pasaportë.

b) Në aneksin nr. 4, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë”, që i bashkëlidhet vendimit, të ndryshuar, hiqet shteti “Kinë, Republika Popullore”, për vizat “C”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 817, datë 18.12.2019

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE TE AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, TË PASURISË 14/86, ZONA KADASTRALE 8571, DHE NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, TË PASURISË 16/51-8, ZONA KADASTRALE 8571, NJËSIA ADMINISTRATIVE LUSHNJË, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 448, DATË 16.6.2005, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 818, DATË 6.12.2006, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë 14/86, zona kadastrale 8571, me sipërfaqe truall 570 m² dhe ndërtesë 265 m², Njësia Administrative Lushnjë, sipas hartës kadastrale bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Lushnjë.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, të ndryshuar.

3. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të pasurisë 16/51-8, zona kadastrale 8571, njësi me sipërfaqe 125 m², Njësia Administrative Lushnjë, sipas hartës kadastrale dhe



planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Agjencisë Tatimore Lushnjë.

4. Pasuria e përmendur në pikën 3, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të


cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, të ndryshuar.

5. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u ndalohej të ndryshojnë destinacionin e përdorimit, t'i tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve pasuritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



HARTE KADASTRALE
(Fragment)

AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

RIKTAN LAME

Njësia e Kadastrës dhe Hartëzimit
Drejtor: Andi PROKO

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 8571 NR.I.PASURISË: 16/51-8 Vol 28 Fq 216

INDEKSI I HARTËS: LU-J-7 SHKALLA: 1:500

ADRESA E PASURISË: LUSHNJË Q/F LUSHNJË 1

LAGJA "KONGRESI I LUSHNJËS" P/G SH K AP

B. KUFIZIMET C. PRONARËT

VERI: _____ REPUBLIKA E SHQIPËRISË


JUG: _____ NË PËRGJËGJESI ADMINISTRIM

LINDJE: _____ TË ZQRPP

PERENDIM: _____

D.Data: 11.10.2019 Ora: _____

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



 Sipërfaqe në pronësi të
Republikës së Shqipërisë
Në përgjegjësi administrimi të ZQRPP
Në përdorim ZVRPP Lushnje
Pasuria 16/51-8, S=125m2



VENDIM

Nr. 818, datë 18.12.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA KORÇË, TË PRONËS NR. 545, ME EMËRTIM “AERODROM FUSHOR”, ME VENDNDODHJE NË KORÇË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Korçë, të pronës nr. 545, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Korçë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 545, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Korçë, sipas planrilevimit.

3. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama





VENDIM

Nr. 819, datë 18.12.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 145, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN “EUFOR”, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK “ALTHEA” TË BASHKIMIT EVROPIAN NË BOSNJË-HERCEGOVINË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr. 145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 26 shkurt 2025. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 820, datë 18.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 910, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 910, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2024. Periudha e qëndrimit në mision, për çdo përfaqësues, të jetë me sistem rotacioni çdo 6 (gjashtë) muaj dhe 1 (një) vit për postin ACOS SPT, periudha, të cilave u shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrje dhe dorëzim detyre, vonesa të transportit strategjik).”.

b) Shkronja “a”, e pikës 5, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 821, datë 18.12.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 911, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË OPERACIONIN
“RSM”, NË SHTABE TË NDRYSHME TË
NATO-s, NË AFGANISTAN”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 911, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Dërgimin me mision të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) ushtarake, në shtabe të ndryshme të NATO-s, në Kabul dhe Herat, Afganistan, si më poshtë vijon:

Në Shtabin e *Resolute Support Mission* (RSM HQ), në operacionin RSM”, në Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 1 (një) ushtarak;
- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndhmës (TAAC-*Capital*), në operacionin “RSM”, Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 4 (katër) ushtarake;
- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Operacioneve të Forcave Speciale të NATO-s (NSOCC-A), në operacionin “RSM”, në Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 1 (një) ushtarak;

- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndhmës në (TAAC-*West*), në operacionin “RSM”, në Herat, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 6 (gjashtë) ushtarake;
- venddislokimi, Herat, Afganistan.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2024. Periudha e qëndrimit në mision, për çdo kontingjent, do të jetë me sistem rotacioni çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik). Për postet *Crisis Establishment* (CE), që plotësohen nga oficerë me gradën “Kolonel”, rotacioni të jetë 1 (një) vit.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM**Nr. 822, datë 18.12.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 912, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
OPERACIONIN “RSM” TË NATO-s,
PRANË KOMANDËS SË BATALIONIT
SHUMËKOMBËSH, NË AFGANISTAN”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave



të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 912, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, numri “... 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) ...” ndryshohet dhe bëhet “... 33 (tridhjetë e tre) ...”;

b) Fjalja e parë e pikës 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2024.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 823, datë 18.12.2019

**PËR PROCEDURËN E BLERJES SË
BANESAVE NË TREGUN E LIRË, QË I
SHTOHEN FONDIT PUBLIK TË
BANESAVE SOCIALE ME QIRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë procedurat për blerjen e banesave në tregun e lirë, të cilat do të përdoren për programin e banesave sociale me qira.

2. Blerja e banesave sociale në tregun e lirë realizohet, si rregull, kur çmimet e shitblerjes së banesave në treg janë më të ulëta se kostoja e ndërtimit të banesave të reja. Njësia e vetëqeverisjes

vendore ose Enti Kombëtar i Banesave kryen blerjen e banesës sociale, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, kur kostoja e ndërtimit të një banese sociale me qira, sipas kushteve, normave dhe standardeve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, është më e madhe se vlera në treg e banesave me të njëjtat kushte, norma dhe standarde.

3. Banesat sociale në tregun e lirë, që do të bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale, mund të blihen mbi koston e ndërtimit vetëm për zgjidhjen e rasteve të përcaktuara në pikat 1 e 2, të nenit 21, të ligjit nr. 22/2018.

Miratimi i rasteve përjashtimore të blerjes së banesave sociale në treg mbi koston e ndërtimit, në varësi të burimit të financimit, bëhet:

a) me vendim të Këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore, kur programi zbatohet nga njësitet e vetëqeverisjes vendore;

b) me vendim të organit drejtues të Entit Kombëtar të Banesave, kur ky përdor burimet e veta të financimit;

c) me urdhër të ministrit përgjegjës për strehimin, kur njësitet e vetëqeverisjes vendore ose institucioni publik i strehimit përdorin fonde që i janë çelur nga buxheti i shtetit.

4. Blerja e banesave sociale me qira kryhet:

a) drejtpërdrejt në treg të lirë; dhe/ose

b) nga shitja e banesave në ankandin e organizuar nga përmbaruesi gjyqësor, pasi ka mbaruar ankandi i parë, sipas procedurës dhe parashikimeve të nenit 557, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në plotësim të kushteve të parashikuara nga shkronja “b”, e nenit 18, të ligjit nr. 22/2018.

5. Banesat që blihen për t’u shtuar fondit të banesave sociale me qira, duhet të plotësojnë normat dhe kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi, që përcakton kushtet, normat dhe standardet e banesave sociale në programet përkatëse të strehimit.

6. Mungesa e elementeve të përshtatshmërisë së banesave për persona me aftësi të kufizuara ose prania e problemeve teknike, si: lagështia, rrjedhja e tubacioneve e të tjera, të ngjashme me to, nuk përbëjnë detyrimisht arsye për refuzimin e blerjes, nëse kostot për riparimin e tyre së bashku me çmimin e ofruar për shitje nuk tejkalojnë koston e ndërtimit të një banese të re. Vlera e investimit i



shtohet vlerës me të cilën është blerë banesa për llogaritjen e masës së qirasë mujore.

7. Njësia përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore ose Entit Kombëtar i Banesave, përpara fillimit të procedurës me shpalljen publike të ftesës për marrjen e ofertave për shitblerjen e banesave sociale, kryen këto veprime:

a) formulon shpalljen e ftesës publike për marrjen e ofertave;

b) përcakton dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e ofertave duke listuar kërkesat dhe kriteret ligjore e teknike;

c) identifikon nevojat që rezultojnë për të përfituar nga fondi i banesave sociale me qira, numrin e familjeve/individëve të interesuar dhe numrin përkatës të anëtarëve për çdo familje;

ç) evidenton për numrin e banesave që mund të blihen dhe strukturën e tyre përkatëse, në varësi të fondit që ka në dispozicion.

8. Shpallja e ftesës për marrjen e ofertave për shitblerjen e banesave sociale bëhet përmes publikimit për tri ditë rresht, në medien e shkruar dhe vizive, me shikueshmërinë ose tirazhin më të lartë të botimit, në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Entit Kombëtar të Banesave, në Buletinën e Njoftimeve Zyrtare vendore dhe Buletinën e Njoftimeve Publike, si dhe në ambiente me frekuentim të lartë si postat, vendet e pagesave të energjisë elektrike, të marrjes së pensionit etj.

Njoftimi përmban:

a) çmimin tavan për blerjen e banesës, i cili nuk duhet të jetë më i lartë se kostoja e ndërtimit në atë njësi të vetëqeverisjes vendore, e përcaktuar sipas çmimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) numrin e apartamenteve që do të blihen;

c) strukturat e apartamenteve dhe sipërfaqet e tyre, sipas normave përkatëse të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) vendndodhjen e dëshiruar;

d) kushtet dhe standardet që duhet të plotësojë banesa, në respektim të kushteve dhe të standardeve të banesave sociale, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Afati brenda të cilit priten të depozitohen ofertat për banesat sociale që mund të blihen nga tregu i lirë është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, duke

filluar nga e nesërmja pas ditës së tretë të publikimit të ofertave në medien e shkruar dhe vizive.

10. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Entit Kombëtar i Banesave, me shpalljen publike të ftesës për marrjen e ofertave për shitblerjen e banesave sociale, ngrenë komisionin e shqyrtimit të ofertave për administrimin e procedurës së shitblerjes. Komisioni përbëhet nga pesë veta: një nënkryetar i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose një drejtor i Entit Kombëtar të Banesave, në rolin e kryetarit të komisionit, një ekonomist, një inxhinier, një jurist dhe një punonjës/e nga strukturat përgjegjëse për strehim, në rolin e anëtarit të caktuar përkatësisht nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose drejtori i përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave. Anëtarë të komisionit caktohen persona të cilët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

11. Ofertat përmbajnë si më poshtë vijon:

a) informacionin në formë tabelare, sipas formatit në shtojcën A që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përmban:

i. adresën e objektit/eve ku ndodhet apartamenti/et;

ii. vitin e ndërtimit të objektit;

iii. katin në të cilin ndodhet apartamenti/et;

iv. orientimin e apartamentit dhe plotësimin e kushteve e të standardeve të parashikuara në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”;

v. sipërfaqen e apartamentit/eve dhe të mjediseve të përbashkëta;

vi. praninë e problemeve teknike (p.sh., funksionimi i rrjetit të ujësjellësit dhe i shkarkimit të ujërave të zeza, praninë e lagështirës etj.);

vii. çmimin e ofruar për shitje, të shprehura në lekë për apartament.

b) certifikatën e pronësisë;

c) kartelën e pasurisë së tre muajve të fundit (seksioni E);

ç) planimetrinë e apartamentit/eve.

12. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në shpalljen publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose Entit Kombëtar të Banesave, brenda afatit kohor të specifikuar në shpallje. Në orën, vendin dhe ditën e shpallur, komisioni i vlerësimit të ofertave fton përfaqësuesit e ofertuesve të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.



13. Me hapjen e ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave ushtron këto detyra:

a) vlerëson ofertat e depozituara dhe çmimet përkatëse për çdo banesë sociale të ofruar për blerje dhe shkualifikon çdo ofertë që dukshëm, bazuar në dokumentet e depozituara, nuk plotëson kushtet e termave të referencës;

b) përzgjedh ofertën/ofertat me vlerën më të ulët të banesave, ndërmjet banesave që plotësojnë kushtet, normat dhe standardet në fuqi;

c) kryen, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hapja e ofertave, këqyrjen e banesave sociale të ofruara për blerje, të cilat inspektohen nga inspektorë të higjienës dhe inxhinierë civilë, për të parë nëse plotësojnë kushtet dhe standardet e përcaktuara për banesat sociale që blihen në treg, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, dhe plotësojnë një formular për rezultatet e inspektimit, sipas modelit të parashikuar në shtojcën B, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kur konstatohen mangësi në dokumentacionin e nevojshëm të ofertave, u kërkohet ofertuesve t'i plotësojnë ato brenda 7 (shtatë) ditëve;

ç) njofton me shkrim subjektin/et e përzgjedhura për t'iu blerë banesën sociale;

d) shpall listën e subjekteve, nga të cilët do të bëhet blerja e banesave sociale, në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të Entit Kombëtar të Banesave.

14. Subjekti/et i/e vlerësuar/a për blerjen e banesave sociale në treg të lirë njoftohen me shkrim. Njoftimi përmban:

a) emrin, adresën e subjektit;

b) identifikimin e banesës, vendndodhjen, parcelën, sipërfaqen;

c) çmimin për apartament dhe vlerën e kontratës;

ç) ftesën për të nënshkruar kontratën.

15. Kur nuk paraqitet asnjë ofertë për blerjen e banesave sociale, thirrja publike rishpallet edhe një herë. Nëse përsëri nuk ka asnjë ofertë, njësia e vetëqeverisjes vendore ose Enti Kombëtar i Banesave rifillon procedurën e vlerësimit të përdorimit të këtij programi pas të paktën 6 (gjashtë) muajve.

16. Kur banesat ose objektet janë në pronësi të ndërmarrjeve shtetërore në likuidim ose në pronësi të të tretëve, fituar nga shitja në ankand e pronës shtetërore, kur në to janë strehuar familjarë me ose pa autorizime nga subjektet shtetërore, kur këto

objekte nuk plotësojnë kushtet teknike, normat e standardet dhe përbëjnë rrezik për jetën e banorëve, kur familjet që banojnë në to janë të rrezikuara të nxirren jashtë me forcë për shkak të lirimit të objektit, kur banorët janë familje/individë që plotësojnë kushtet sociale të parashikuara në nenin 16, të ligjit nr. 22/2018, si edhe me mirëkuptim me pronarin e objektit, përjashtimisht, banesa sociale mund të blihet në treg pa zhvilluar procedurën e shpalljes publike të thirrjes për oferta.

Njësia e vetëqeverisjes vendore ose Enti Kombëtar i Banesave mbështetet financiarisht nga buxheti i shtetit, kur me të ardhurat e tyre nuk përballojnë financimin për blerjen e objektit dhe/ose investimin për përshtatjen e tij gradualisht me kushtet, normat dhe standardet në fuqi. Çmimi i blerjes negociohet ndërmjet palëve, pasi të jetë bërë një vlerësim paraprak i gjendjes së tregut dhe i kostos së investimit për përshtatjen e banesës në raport me vlerën e një ndërtimi të ri në treg nga struktura përgjegjëse për strehimin. Vendimi për blerjen merret nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshilli drejtues i Entit Kombëtar të Banesave, vetëm nëse vlerësimi paraprak i bërë tregon se kostot për blerjen e objektit dhe investimit për përshtatjen graduale do të ishin më të ulëta se sa kostot për ndërtimin e një objekti të ri, si edhe kur plotësohet njëri nga rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 21, të ligjit nr. 22/2018. Banesa ose objekti i blerë i shtohet fondit publik të banesave sociale.

17. Kontrata për blerjen e banesave të destinuara për t'u dhënë me qira, si pjesë e fondit publik të banesave sociale, bëhet me akt noterial dhe lidhet ndërmjet kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose titullarit të Entit Kombëtar të Banesave ose personit të autorizuar prej tyre, dhe subjektit publik ose privat në rolin e shitësit. Kontrata parashikon kalimin e objektit në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose Entit Kombëtar të Banesave, së bashku me pjesën në bashkëpronësi, sipas dispozitave të Kodit Civil dhe ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009, "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit". Njësia e vetëqeverisjes vendore/Enti Kombëtar i Banesave ushtron të njëjtat detyrime dhe të drejta që burojnë nga statusi si bashkëpronar.

18. Kontrata për blerjen e banesave sociale në treg, të destinuara për dhënie me qira, i dërgohet



Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e kalimit të së drejtës së pronësisë në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose Entit Kombëtar të Banesave, si pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira.

19. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, Enti Kombëtar i Banesave dhe subjektet e tjera që

financojnë për zbatimin e programeve të blerjes së banesave që do të jepen me qira për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA A FORMULARI I OFERTËS

Emër/atësia/mbiemër _____; nr. ID _____,
Adresa: _____; Numër telefoni: _____; Adresë
email-i: _____,
OFROJ:
_____ (numër apartamente), të cilat ndodhen në objektin (objektet) e banimit me të dhëna, si më poshtë:
Objekti 1
Adresa: _____ (qyteti) _____, bashkia _____
Bashkia _____

Apartam enti	Sipërfa qja ¹	Përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpronësi ²	Struktu ra ³	Kati ⁴	Gjendja e apartamentit ⁵	Çmimi i ofruar ⁶	Komen te/ sqarime
1							
2							
3							

Viti i ndërtimit _____

Është i pajisur me ashensor: PO JO

☐
☐

Bashkëlidhur:

- certifikata/t e pronësisë;
- vërtetim, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që prona nuk është e rënduar me ndonjë barrë;
- planimetrinë (planimetritë) e apartamentit.

¹ Sipërfaqja e apartamentit siç jepet në certifikatën e pronësisë.

² Pjesa e pronësisë së përbashkët që i takon apartamentit siç jepet në certifikatën e pronësisë.

³ Të shënohet: G për garsonierë; 1+1 për ap. me një dhomë gjumi dhe një ndenjësë; 2+1 për dy dhoma gjumi e një ndenjësë, e kështu me radhë.

⁴ Numërimi i katit të fillojë nga 0, ku me 0 shënohet kati i hyrjes në objekt.

⁵ Të jepet informacion mbi probleme të mundshme me lagështinë e mureve, tarracës, dyshemesë së katit përdhes, banjës, rrjedhje tubacioni uji etj.

Vini re! Prania e problemeve teknike nuk përbën kusht përjashtimor.

⁶ Çmimi jepet në formatin lekë për apartament.



SHTOJCA B
FORMULAR TIP INSPEKTIMI

Komisioni i inspektimit, sipas vendimit nr. _____, datë _____, të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për blerjen e banesave sociale në treg, i përbërë nga:

1. _____, specialist inxhinier ndërtimi/arkitekt;
2. _____, specialist hidrosanitar;
3. _____, specialist në fushën e higjienës/shëndetësisë.

Inspektoi apartamentin e z./znj. _____, me adresë: qyteti _____, lagja _____, rr. _____, pallati nr. _____, hyrja nr. _____.

Gjatë inspektimit në objekt u verifikua gjendja:

1. Në përputhshmëri me normat dhe standardet në fuqi për banesat sociale

☐

2. Në përputhshmëri të pjesshme

☐

3. Në papërputhshmëri

☐

Veçanërisht është verifikuar gjendja fizike, e cila rezultoi, si më poshtë:

1. Gjendja e përgjithshme e ndërtimit

1.1 Sipërfaqja e apartamentit sipas dokumentit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës _____ m²

1.2 Zbërthim i sipërfaqeve të ambienteve të banimit:

- a) dhomë dite _____ m²;
- b) dhomë gjumi (1) _____ m²;
- c) dhomë gjumi (2) _____ m²;
- ç) dhomë gjumi (3) _____ m²;
- d) aneks gatimi _____ m²;
- dh) banjë _____ m²;
- e) korridor _____ m²;
- ë) depo _____ m²;
- f) ambiente të përbashkëta _____ m².

2. Gjendja fizike e apartamentit:

2.1 Muratura mbajtëse

Po Jo

a) janë bërë ndërhyrje me projekt që nuk prishin konstruksionin mbajtës

☐ ☐
☐ ☐

b) janë bërë ndërhyrje pa projekt, që mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e objektit

2.2 Muratura ndarëse

a) janë bërë ndryshime të muraturës ndarëse

☐ ☐

2.3 Suvatimi i mureve

a) suvatimi është në gjendje të mirë

☐ ☐

b) suvatimi ka nevojë për riparime në masën _____ m²

☐ ☐

2.4 Shtresat

a) shtresat janë në gjendje të mirë

☐ ☐

b) shtresat janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për riparime në masën _____ m²

2.5 Veshje murature banja/ aneks me materiale të padepërtueshme

a) veshjet janë në gjendje të mirë

☐ ☐

b) veshjet janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për riparime në masën _____ m²

2.6 Dyer dhe dritare

a) dyert janë në gjendje të mirë

☐ ☐



b) dritaret janë në gjendje të mirë

☐ ☐

c) dyert janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për t'u ndërruar _____ copë

d) dritaret janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për t'u ndërruar _____ copë

3. Gjendja teknike

3.1 Sistemi hidrosanitar

a) në gjendje të mirë

☐ ☐

b) rrjeti paraqet defekte dhe ka nevojë për t'u riparuar me vlerë _____ lekë

3.2 rrjeti elektrik

a) në gjendje të mirë

☐ ☐

b) rrjeti ka nevojë për riparime në _____ lekë

3.3 Telefonia

a) në gjendje të mirë

☐ ☐

b) rrjeti ka nevojë për riparime në _____ lekë

3.4 Ngrohja

a) sistemi i ngrohjes në gjendje të mirë

☐ ☐

b) sistemi i ngrohjes është i dëmtuar dhe ka nevojë për _____ lekë riparime

3.5 Pajisjet hidrosanitare të banjës

a) pajisjet janë në gjendje të mirë

☐ ☐

b) pajisjet nuk janë në gjendje të mirë kanë nevojë për t'u zëvendësuar

Shënim. Formulari i inspektimit shoqërohet me relacionin teknik dhe ekonomik, sipas zërave të formularit dhe konkluzioneve të inspektimit.

VENDIM

Nr. 825, datë 18.12.2019

PËR SUBVENCIONIMIN E DHOMËS KOMBËTARE TË ZEJTARISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45, të ligjit nr. 70/2016, "Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetjen e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, për një periudhë njëvjeçare, në masën 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga shpenzimet korrente në programin "Tregu i punës", miratuar

për vitin 2019, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 826, datë 18.12.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KOMUNA E PARISIT-RRUGË E RE TIRANË-ELBASAN" (SHTESA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në



përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Komuna e Parisit–Rrugë e Re Tiranë–Elbasan” (shtesa).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me vlerë 3 626 125 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 626 125 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2019, zëri “Shpronësime”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen për

efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit (Autoritetit Rrugor Shqiptar).

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit (Autoritetit Rrugor Shqiptar) për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘KOMUNA E PARISIT–RRUGA E RE TIRANË–ELBASAN’” (SHTESA)

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi	Vlera totale / lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
						tokë truall / m ²			
1	Atlije Hajdar Brari	8280	1/61	truall	875	23	29,543	679,489	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Andi Pandeli Dervishi	8270	8/353	truall	234	5	66,969	334,845	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Bashkëpronarët Brari	8270	8/998	truall	115	39	66,969	2,611,791	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale e shpronësimit								3,626,125	



VENDIM

Nr. 827, datë 18.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 489, DATË 19.7.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I NËNSTACIONIT 110 kV ORIKUM DHE
NËNSTACIONIT 110 kV HIMARË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 489, datë 19.7.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 884.37 (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) m² tokë arë, me shumën e përgjithshme 384 412 (treqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë.”.

b) Tabelës, bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST, sh.a.), Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT**

“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110 kV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 kV HIMARË”

Për disa shtesa në VKM-në nr. 489, datë 19.7.2017 “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe nënstacionit 110 kV Himarë”

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr/pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi	Vlera totale / Lekë	Shënime
					Tokë Arë / m ²	Tokë Arë / m ²		
1	Sherif Lushaj	3621	1000/6	1000	38.38	204	7,830	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Shadije Gjonzeneli	2832	28/18	10000	47.1	204	9,608	Konfirmuar nga ZVRPP
Vlera totale e shpronësimit					85.48		17,438	



VENDIM

Nr. 830, datë 18.12.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR GRUMBULLIMIN, AMBALAZHIMIN, TRANSPORTIN, RUAJTJEN, ETIKETIMIN, NJOFTIMIN E AKTIVITETIT DHE KONTROLLIN E PRODUKTEVE BIOLOGJIKE⁷

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 18, 29, 33 e 36, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të hollësishme për grumbullimin, ambalazhimin, transportin, ruajtjen, etiketimin, njoftimin e aktivitetit dhe kontrollin e produkteve biologjike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, trupat e kontrollit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë:

- a) rregullat për grumbullimin, ambalazhimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve biologjike;
- b) rregullat e hollësishme për etiketimin, paraqitjen, përbërjen dhe përmasat e treguesve të

⁷ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me rregulloret e Këshillit (KE): nr. 889/2008, datë 5 shtator 2008, që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e rregullores së Këshillit 834/2007, “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike në lidhje me prodhimin biologjik, etiketimin dhe kontrollin”, të ndryshuar. Numri CELEX: 02008R0889-20160507, “Fletorja Zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria L nr. 250, datë 18.9.2008, faqe 1–17.

detyrueshëm të etiketimit dhe rregullat për përbërjen, paraqitjen, madhësinë dhe dizënjimin e logos kombëtare për prodhimin biologjik;

c) rregullat e detajuara për procedurën e njoftimit të aktivitetit nga operatorët biologjikë, dhe forma e certifikatës së operatorit;

ç) rregullat e hollësishme për kontrollin e produkteve biologjike.

**Neni 2
Përkufizime**

Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” (më poshtë “ligji”), kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “**Dosje kontrolli**”, dosja që përmban të gjithë informacionin dhe dokumentet që transmetohen nga operatori i prodhimit biologjik tek autoriteti kompetent ose trupa e kontrollit.

2. “**Importues**”, personi fizik ose juridik, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili paraqet një ngarkesë për çlirim për qarkullim të lirë, në Republikën e Shqipërisë, personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi.

3. “**Marrësi i parë**”, personi, fizik ose juridik, që merr ngarkesën e importuar, për përgatitje dhe/ose tregim të mëtejshëm.

**KREU II
GRUMBULLIMI, AMBALAZHIMI,
TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I
PRODUKTEVE BIOLOGJIKE****Neni 3
Grumbullimi i produkteve dhe transportimi
në njësitë e përgatitjes**

1. Operatorët mund të kryejnë, njëkohësisht, grumbullimin e produkteve biologjike dhe jobiologjike, vetëm nëse merren masa të përshtatshme për të parandaluar çdo përzjerje ose shkëmbim të mundshëm me produktet jobiologjike dhe për të siguruar identifikimin e produkteve biologjike.

2. Operatori mban informacionin, i cili i vihet në dispozicion trupës së kontrollit, për:

- a) ditën dhe orën e grumbullimit;



- b) qarkullimin;
- c) datën dhe orën e pranimit të produkteve.

Neni 4

Ambalazhimi dhe transporti i produkteve tek operatorët ose njësitë e tjera

1. Operatorët sigurojnë që produktet biologjike të transportohen tek operatorët ose njësitë e tjera, përfshirë shitësit me shumicë dhe pakicë, vetëm në ambalazhe të përshtatshme, kontejnerë ose mjete transporti, të mbyllura në mënyrë të tillë që zëvendësimi i përmbajtjes së produktit nuk mund të ndodhë pa ndryshim apo dëmtim të vulës dhe të jetë i pajisur me etiketë e cila, përveç treguesve të tjerë, sipas legjislacionit në fuqi për etiketimin, përmban edhe:

a) emrin dhe adresën e operatorit dhe kur janë të ndryshëm edhe të pronarit ose të shitësit të produktit;

b) emrin e produktit ose një përshkrim në rastin e ushqimit të përbërë për kafshë, të shoqëruar me një referencë për metodën e prodhimit biologjik;

c) emrin dhe numrin kodues të trupës së kontrollit që certifikon operatorin;

ç) kur është e mundur, treguesin e identifikimit të lotit, që mundëson lidhjen e sasisë së produktit me dokumentacionin financiar, sipas nenit 21, të këtij vendimi, të dakordësuar me trupën e kontrollit.

2. Informacioni sipas pikës 1, të këtij neni, mundet të paraqitet edhe në një dokument shoqërues, që lidhet me ambalazhin, kontejnerin ose mjetin e transportit të produktit. Ky dokument shoqërues përmban edhe informacionin për furnizuesin dhe/ose transportuesin e produktit.

3. Mbyllja e ambalazhit, e kontejnerit ose e automjetit nuk kërkohet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) transporti kryhet direkt midis dy operatorëve, të cilët janë objekt i sistemit të kontrollit organik;

b) produktet shoqërohen nga një dokument që përmban informacionin e kërkuar sipas pikës 1, të këtij neni;

c) të dy operatorët, dërguesi dhe pranuesi mbajnë të dhëna të dokumentuara për veprimet e transportit, të cilat i vihen në dispozicion trupës së kontrollit që kontrollon transportin.

Neni 5

Rregulla të veçanta për transportin e ushqimit për kafshë, në njësitë e tjera të prodhimit, të përgatitjes ose të ruajtjes

Kur transportohet ushqim për kafshë në njësitë e tjera të prodhimit, të përgatitjes ose të magazinimit, përveç kërkesave të përcaktuara në nenin 4, të këtij vendimi, operatorët duhet të plotësojnë edhe kushtet e mëposhtme:

a) gjatë transportit, ushqimet biologjike për kafshë, ushqimet për kafshë në kalim dhe ato jobiologjike duhet të ndahen fizikisht në mënyrë efikase;

b) mjetet dhe/ose kontejnerët që janë përdorur për transportin e produkteve jobiologjike përdoren për transportin e produkteve biologjike, me kusht që:

i. të jetë kryer pastrimi i duhur dhe të jetë kontrolluar efikasiteti i tij, përpara kryerjes së transportit të produkteve biologjike. Operatorët të mbajnë të dhëna të dokumentuara për kryerjen e këtyre veprimeve;

ii. të zbatohen të gjitha masat e duhura, bazuar në vlerësimin e riskut, dhe operatorët të garantojnë që produktet jobiologjike nuk vendosen në treg me tregues që i referohet prodhimit biologjik;

iii. operatori mban të dhëna të dokumentuara për veprimet e transportit, të cilat i paraqiten trupës së kontrollit;

c) transporti i ushqimit biologjik, të përfunduar për kafshë, kryhet i ndarë fizikisht ose në kohë, nga transporti i produkteve të tjera të përfunduara;

ç) gjatë transportit regjistrohet sasia e produktit në fillim dhe çdo sasi individuale e shpërndarë.

Neni 6

Transporti i peshkut të gjallë

1. Peshqit e gjallë duhet të transportohen në tankerë të përshtatshëm, me ujë të pastër, të cilët plotësojnë nevojat e tyre fiziologjike në lidhje me temperaturën dhe oksigjenin e tretur.

2. Para transportimit të peshkut biologjik dhe të produkteve të tij, tanket duhet të pastrohen, të dezinfektohen dhe të shpëlahen në mënyrë të duhur.

3. Gjatë transportit të merren masa paraprake për të zvogëluar stresin e peshqve dhe dendësia e tyre nuk duhet të arrijë në nivelin që është i dëmshëm për speciet.



4. Për veprimet e kryera sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, duhet të mbahen të dhëna të dokumentuara.

Neni 7

Pranimi i produkteve nga njësitë dhe operatorët e tjerë

1. Në momentin e pranimi nga njësitë ose operatorët e tjerë, të produkteve biologjike të cilat duhet të jenë të mbyllura, operatori kontrollon mbylljen e ambalazhit ose të kontejnerit, si dhe praninë e treguesve të përcaktuar në nenin 4, të këtij vendimi.

2. Operatori verifikon informacionin në etiketë me informacionin në dokumentet shoqëruese. Rezultati i këtyre verifikimeve shënohet në dokumentacionin financiar, sipas përcaktimit në nenin 18, të këtij vendimi.

Neni 8

Ruajtja e produkteve

1. Në ambientet e ruajtjes së produkteve duhet të sigurohet identifikimi i loteve dhe të shmanget çdo përzjerje ose kontaminim nga produktet dhe/ose substancat që nuk plotësojnë kërkesat e prodhimit biologjik. Produktet biologjike duhet të identifikohen qartësisht në çdo kohë.

2. Në njësitë e prodhimit biologjik bimor, blegtoral, të algave të detit, akuakulturës, ndalohej magazinimi i *input*-eve që nuk lejohen të përdoren në prodhimin biologjik.

3. Magazinimi në ferma i produkteve mjekësore veterinarë alopatiche dhe antibiotikëve lejohet vetëm kur përdorimi i tyre rekomandohet nga një veteriner, në rastet e trajtimit sipas përcaktimit të nënndarjes “ii”, të shkronjës “d”, të nenit 14, ose të nënndarjes “ii”, të shkronjës “dh”, të nenit 15, të ligjit. Këto produkte ruhen në një vend të mbikëqyrur dhe regjistrohen në regjistrin e kafshëve, në rastin e prodhimit biologjik blegtoral dhe në regjistrin e prodhimit të akuakulturës, në rastin e prodhimit të akuakulturës biologjike.

4. Në rastet kur operatorët trajtojnë produkte jobiologjike e biologjike dhe këto të fundit magazinohen në të njëjtat ambiente me produktet e tjera bujqësore dhe ushqimore duhet që:

a) produktet biologjike të mbahen të ndara nga produktet e tjera bujqësore dhe/ose ushqimore;

b) të merren masa që të sigurohet identifikimi i ngarkesave dhe të shmanget përzjerja ose shkëmbimi me produktet jobiologjike;

c) para magazinimit të produkteve biologjike të merren masa për pastrimin efektiv të ambienteve të magazinimit, veprime të cilat dokumentohen.

Neni 9

Grumbullimi, ruajtja, ambalazhimi, transporti dhe kontrolli i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET), përveç kërkesave të përcaktuara në këtë krye, kryhet edhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10120, datë 23.4.2009, “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”.

KREU III

KËRKESAT PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE BIOLOGJIKE

Neni 10

Përveç kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për etiketimin e produkteve ushqimore dhe të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, produktet biologjike duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta të etiketimit, të përcaktuara në këtë krye.

Neni 11

Logoja kombëtare e prodhimit biologjik

1. Logo përdoret në etiketim vetëm nëse produktet prodhohen në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nga operatorët të cilët plotësojnë kërkesat e sistemit të kontrollit dhe të tregutit të këtyre produkteve.

2. Përbërja, paraqitja, madhësia dhe dizenjimi i logos kombëtare të prodhimit biologjik (më poshtë logo) të jetë sipas modelit të paraqitur në aneksin I, të këtij vendimi.

Neni 12

Kushtet për përdorimin e numrit kodues dhe të vendit të origjinës

1. Numri kodues i trupës së kontrollit duhet:



a) të fillojë me akronimin AL (që identifikon Shqipërinë);

b) të përmbajë termin “Bio”, i cili tregon metodën e prodhimit biologjik;

c) të përmbajë një numër identifikues progresiv, i cili do të përmbajë 3 shifra që përcaktohen nga Komisioni për Bujqësinë Biologjike (duke filluar nga numri 001);

ç) të vendoset në të njëjtën fushëpamje me logon dhe treguesin e vendit të origjinës, ku janë prodhuar lëndët e para bujqësore, prej të cilave përbëhet produkti.

2. Treguesi i vendit të origjinës, ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore nga të cilat përbëhet produkti, vendoset menjëherë poshtë numrit kodues, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Neni 13

Përdorimi i markës tregtare dhe i përshkrimit të produktit për shitje në ushqimin për kafshët që përdoren për ushqim

Marka tregtare dhe përshkrimi i produktit për shitje, të cilat përmbajnë termat “biologjik”, “organik”, “bio”, ose “eko”, përdoren vetëm nëse të gjithë përbërësit e produktit me origjinë bimore ose shtazore janë biologjikë dhe, të paktën, 95% e lëndës së thatë të produktit përbëhet nga përbërës të tillë.

Neni 14

Treguesit e etiketimit në ushqimin e përpunuar, biologjik për kafshë

1. Termat “biologjik” ose “organik” dhe “logo” përdoren në etiketimin e ushqimit të përpunuar për kafshë, kur:

a) ushqimi i përpunuar për kafshë plotëson kërkesat e ligjit dhe në veçanti të nënndarjeve “iv” dhe “v”, të shkronjës “ç”, të nenit 14, për blegtorinë, ose të shkronjës “ç”, të nenit 15, për speciet e akuakulturës, dhe të nenit 19 të tij;

b) ushqimi i përpunuar për kafshë të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për prodhimin biologjik blegtoral dhe ushqimin e përpunuar, biologjik, për kafshë;

c) të gjithë përbërësit me origjinë bimore ose shtazore, që gjenden në ushqimin e përpunuar, biologjik, për kafshë, duhet të jenë biologjikë;

ç) të paktën 95% e lëndës së thatë të produktit të përbëhet nga produkte bujqësore biologjike.

2. Në zbatim të kërkesave të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, në rastin e produkteve që përmbajnë sasi të ndryshme të lëndëve ushqimore biologjike për kafshë, dhe/ose në kalim dhe/ose jobiologjike të lejuara të përdoren në prodhimin biologjik, lejohet të përdoret shprehja “mund të përdoret në prodhimin biologjik, në përputhje me legjislacionin për prodhimin biologjik”.

Neni 15

Kushtet për përdorimin e treguesve të etiketimit në ushqimin e përpunuar për kafshë

1. Treguesit e përcaktuar në nenin 14, të këtij vendimi, duhet:

a) të ndahen nga treguesit e detyrueshëm, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për etiketimin e ushqimit për kafshë;

b) të paraqiten në ngjyrë, format ose shkrim që nuk tërheq vëmendje më shumë se përshkrimi ose emri i ushqimit për kafshë, të përcaktuar në legjislacionin për etiketimin e ushqimit për kafshë;

c) të shoqërohen në të njëjtën fushëpamje me një tregues për peshën e lëndës së thatë, duke iu referuar:

i. përqindjes së lëndëve ushqimore biologjike për kafshë;

ii. përqindjes së lëndëve ushqimore për kafshë nga produkte në kalim drejt bujqësisë biologjike;

iii. përqindjes së lëndëve ushqimore për kafshë, që nuk përfshihen në nënndarjet “i” dhe “ii”, të kësaj pike;

iv. përqindjes së përgjithshme të ushqimit për kafshë me prejardhje bujqësore;

ç) të shoqërohen me një listë të emrave të lëndëve ushqimore, biologjike për kafshë;

d) të shoqërohen nga një listë e emrave të lëndëve ushqimore për kafshë nga produkte në kalim drejt bujqësisë biologjike.

2. Përveç treguesve të përcaktuar në nenin 14, të këtij vendimi, mund të referohet edhe detyrimi për të përdorur ushqimin për kafshë në përputhje me legjislacionin për prodhimin biologjik blegtoral.

Neni 16

Kërkesa të veçanta për etiketimin e produkteve bimore në kalim

Produktet bimore në kalim mund të mbajnë treguesin “produkt në kalim në bujqësinë biologjike”, me kusht që:



a) të jetë plotësuar një periudhë kalimi, të paktën 12-mujore, para vjeljes apo mbledhjes së tyre;

b) treguesi të paraqitet në ngjyrë, madhësi dhe shkrim të tillë që të mos jetë më i dukshëm se përshkrimi i shitjes së produktit dhe të gjithë treguesit të kenë të njëjtën madhësi shkronjash;

c) produkti të përmbajë vetëm një përbërës bimor me origjinë bujqësore;

ç) treguesi të lidhet me emrin dhe numrin kodues të trupës së kontrollit.

KREU IV RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË KONTROLLIT

Neni 17

Masat e kontrollit

1. Kur operatori përfshihet në sistemin e kontrollit për herë të parë, përveç plotësimit të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për ushqimin dhe atë për mbrojtjen e mjedisit, duhet të përgatisë, të përditësojë dhe të paraqesë te trupa e kontrollit:

a) një përshkrim të plotë të njësisë së prodhimit dhe/ose të stabilimentit dhe/ose të aktivitetit;

b) masat që ndërmerren në nivel njësie dhe/ose stabilimenti dhe/ose aktiviteti, për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e prodhimit biologjik;

c) masat parandaluese që ndërmerren për të reduktuar rrezikun e kontaminimit nga produktet ose substancat që nuk lejohen të përdoren në prodhimin biologjik dhe masat për pastrimin e magazinave dhe në të gjithë zinxhirin e prodhimit;

ç) karakteristikat specifike të metodës së prodhimit të përdorur, kur operatori kërkon t'i lëshohet certifikatë, siç përcaktohet në nenin 23, të këtij vendimi.

2. Kur është e përshtatshme, përshkrimi dhe masat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të jenë pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë të ngritur nga operatori.

Neni 18

Deklarata dhe detyrimet e operatorit

1. Përshkrimi dhe masat e përcaktuara në nenin 17, të këtij vendimi, përfshihen në një deklaratë të nënshkruar nga operatori përgjegjës. Deklarata përmban edhe angazhimin që operatori të pranojë:

a) të kryejë aktivitetin në përputhje me rregullat e prodhimit biologjik;

b) zbatimin e masave korrigjuese në përputhje me rregullat e prodhimit biologjik, në rastin e shkeljeve ose të parregullsive;

c) të informojë, me shkrim, blerësit e produktit, për të hequr nga produkti treguesit që i referohen metodës së prodhimit biologjik, në rastin e produkteve që rezultojnë jobiologjike;

ç) shkëmbimin e informacionit ndërmjet trupave të kontrollit, në rastet kur operatori dhe/ose nënkontraktorët e tij janë kontrolluar nga trupa kontrolli të ndryshme, në përputhje me kërkesat e ligjit;

d) të kalojë dosjen e kontrollit te trupa tjetër e kontrollit, në rastet kur operatori dhe/ose nënkontraktorët e tij ndryshojnë trupën e kontrollit;

dh) të informojë menjëherë autoritetin kompetent dhe trupën e kontrollit, në rastet kur operatori tërhiqet nga sistemi i kontrollit;

e) që dosja e kontrollit të ruhet për një periudhë, të paktën, pesëvjeçare në rastet kur operatori tërhiqet nga sistemi i kontrollit;

ë) të informojë pa vonesë trupën e kontrollit për çdo parregullsi apo shkelje që ndikon në statusin biologjik të produkteve të tij ose të produkteve biologjike të furnizuara nga operatorët e tjerë ose nënkontraktorët.

2. Deklarata sipas pikës 1, të këtij neni, verifikohet nga trupa e kontrollit, e cila përpilon një raport inspektimi, ku identifikohen, nëse ka, mangësitë dhe mospërputhjet e mundshme me rregullat e prodhimit biologjik. Raporti nënshkruhet edhe nga operatori, i cili, në rastin e konstatimit të mospërputhjeve me rregullat e prodhimit biologjik, duhet të ndërmarrë masat korrigjuese të nevojshme.

Neni 19

Njoftimi i aktivitetit dhe i ndryshimeve në masat e kontrollit

1. Çdo operator që prodhon, përgatit, ruan, importon, eksporton nga/në një vend tjetër ose tregon produkte biologjike ose në kalim, përpara vendosjes së tyre në treg duhet të njoftojë autoritetin kompetent mbi aktivitetin e tij.

2. Forma e njoftimit është sipas modelit të përcaktuar në aneksin II, bashkëlidhur këtij



vendimi. Pas njoftimit operatori regjistrohet në regjistrin e operatorëve të prodhimit biologjik.

3. Operatori njofton menjëherë autoritetin kompetent dhe trupën e kontrollit, për çdo ndryshim, në përshkrimin dhe/ose masat e përcaktuara në këtë nen dhe në nenet 17 dhe 18, të këtij vendimi.

Neni 20 Inspektimet

1. Trupa e kontrollit kryen, të paktën një herë në vit, një inspektim fizik të të gjithë operatorëve që ka në sistemin e tij të kontrollit.

2. Trupa e kontrollit merr dhe analizon mostra për identifikimin e produkteve të palejuara për t'u përdorur në prodhimin biologjik, kontrollin e përputhshmërisë së teknikave të prodhimit me rregullat e prodhimit biologjik dhe/ose identifikimin e kontaminimit të mundshëm nga produktet e palejuara për prodhimin biologjik.

3. Numri i mostrave të marra dhe të analizuara në vit nga trupa e kontrollit duhet të jetë të paktën 5% e numrit të operatorëve në sistemin e kontrollit të saj.

4. Përzgjedhja e operatorëve për të marrë mostra për analizim kryhet mbi bazën e vlerësimit të përgjithshëm të riskut, të mospërputhjes me rregullat e prodhimit biologjik. Ky vlerësim i përgjithshëm duhet të marrë parasysh të gjitha stadet e prodhimit, të përgatitjes dhe të shpërndarjes.

5. Trupa e kontrollit merr dhe analizon mostra, në çdo rast, kur dyshohet që përdoren produkte apo teknika të palejuara për prodhimin biologjik dhe, në këto raste, nuk ka asnjë kufizim në numër për marrjen e mostrave.

6. Trupa e kontrollit mund të marrë dhe analizojë mostra, në çdo rast tjetër, për identifikimin e produkteve të palejuara për t'u përdorur në prodhimin biologjik, kontrollin e përputhshmërisë së teknikave të prodhimit me rregullat e prodhimit biologjik dhe/ose identifikimin e kontaminimit të mundshëm nga produktet e palejuara për prodhimin biologjik.

7. Analizimi i mostrave të marra nga trupa e kontrollit duhet të kryhet në laboratorë të akredituar.

8. Pas çdo inspektimi përpilohet raport inspektimi, i cili nënshkruhet nga operatori i njësisë

ose përfaqësuesi i tij dhe trupa e kontrollit. Raporti i kontrollit hartohet në dy kopje, nga të cilat një kopje i jepet operatorit.

9. Trupa e kontrollit kryen inspektime të rastësishme, të palajmëruara, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të riskut të mospërputhjes me rregullat e prodhimit biologjik, duke marrë parasysh, të paktën, rezultatet e inspektimeve të mëparshme, sasinë e produkteve përkatëse, të ankesave të bazuara në lidhje me produktin biologjik dhe rrezikun për shkëmbimin e produktit.

10. Autoriteti kompetent i kërkon trupës së kontrollit dokumentacionin e procedurës së analizës së riskut.

11. Procedura për vlerësimin e riskut duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që:

a) rezultati i analizës së riskut të jetë bazë për përcaktimin e intensitetit të inspektimeve vjetore, të paralajmëruara ose të paparalajmëruara;

b) të kryhen inspektime të rastësishme shtesë, të paktën në 10% të operatorëve të kontraktuar, bazuar në nivelin e riskut;

c) të paktën 10% e të gjitha inspektimeve të jenë pa paralajmërim.

Neni 21 Dokumentacioni financiar

1. Të dhënat financiare dhe inventari mbahen nga njësitë ose stabilimentet e prodhimit, të cilat i mundësojnë operatorit të identifikojë, dhe trupës së kontrollit të verifikojë:

a) furnizuesin dhe, kur janë të ndryshëm, shitësin ose eksportuesin e produktit;

b) natyrën dhe sasinë e produkteve biologjike të blera nga njësia e prodhimit dhe, sipas rastit, të gjitha materialet e blera dhe përdorimin e tyre dhe/ose përmbajtjen e ushqimeve të përbëra për kafshë;

c) natyrën dhe sasinë e produkteve biologjike që ruhen në magazinën e stabilimentit;

ç) natyrën, sasinë dhe marrësit e ngarkesave dhe, kur janë të ndryshëm, blerësit e tjerë që nuk janë konsumatori i fundit, të çdo produkti të dalë nga njësia ose stabilimenti ose magazina e marrësit të parë;

d) rastin e operatorëve të cilët nuk magazinon ose trajtojnë fizikisht këto produkte biologjike, natyrën dhe sasinë e produkteve biologjike të blera e të shitura, furnizuesit dhe, kur janë të ndryshëm,



shitësit, eksportuesit, blerësit apo marrësit e ngarkesës.

2. Dokumentacioni financiar përmban edhe rezultatet e verifikimit gjatë pranimit të produkteve biologjike dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga trupa e kontrollit, me qëllim kryerjen e një kontrolli të rregullt.

3. Të dhënat financiare shoqërohen me dokumentet provuese dhe duhet të tregojnë balancën ndërmjet hyrjeve dhe daljeve.

4. Kur një operator menaxhon disa njësi prodhimi biologjike dhe jobiologjike në të njëjtin vend, atëherë edhe njësitë e prodhimit jobiologjike së bashku me magazinat e *input*-eve duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme të kontrollit, të përcaktuara në këtë krye.

Neni 22

Aksesi në ambientet e aktivitetit të operatorit

1. Për qëllim të kryerjes së inspektimeve dhe kontrolleve, operatori duhet:

a) të lejojë trupën e kontrollit të kryejë kontrolle, në të gjitha ambientet e njësisë së prodhimit, stabilimentit, llogaritë financiare dhe dokumentacionin provues përkatës;

b) të ofrojë trupës së kontrollit çdo informacion të nevojshëm për qëllim kontrolli;

c) të paraqesë rezultatet e programeve të tij të menaxhimit të cilësisë, kur kërkohet nga trupa e kontrollit.

2. Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, importuesi dhe marrësi i parë i produktit paraqesin për ngarkesat e importuara edhe informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e marrësit të parë;

b) çdo informacion të hollësishëm që trupa e kontrollit kërkon në lidhje me certifikatën e operatorit ose certifikatën e inspektimit.

3. Importuesi i përcjell informacionin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, me kërkesë të trupës së tij të kontrollit, edhe trupës së kontrollit të marrësit të parë.

Neni 23

Certifikata e operatorit

1. Trupa e kontrollit lëshon certifikatën për çdo operator të kontrolluar prej saj, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Modeli i certifikatës së operatorit përcaktohet në aneksin III, të këtij vendimi.

Neni 24

Deklarata e shitësit

1. Për ushqimet dhe ushqimet për kafshë, operatori që përdor produkte jobiologjike, do t'i kërkojë shitësit të plotësojë deklaratën se produktet e furnizuara prej tij nuk janë prodhuar me OMGJ.

2. Për lëndët ndihmëse në përpunim, produktet për mbrojtjen e bimëve, plehrat e përdorimit bujqësor, përmirësuesit e tokës, materiali mbjellës dhe shumëzues bimorë, mikroorganizmat dhe kafshët, operatori që përdor produkte të tilla jobiologjike, do t'i kërkojë shitësit të plotësojë deklaratën se produktet e furnizuara prej tij nuk janë OMGJ dhe nuk janë prodhuar nga/ose me OMGJ.


3. Modeli i deklaratës së shitësit përcaktohet në aneksin IV, të këtij vendimi.

ANEKSI I
LOGO KOMBËTARE PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK

1. Logoja kombëtare për prodhimin biologjik, referuar nenit 11, të këtij vendimi, duhet të jetë sipas modelit të mëposhtëm:



2. Ngjyrat e referencës janë e bardhë dhe jeshile, si më poshtë vijon:



e bardhë



Jeshile

CMYK: C-50 / M-0 / Y-100 / K-0

Pantone: 376

RGB: 169 / 201 / 56

3. Hapësira midis elementeve të logos (shkrimi BIO dhe shqiponja) dhe fundit të ngjyrës jeshile, përcaktohet duke shumëzuar me 2 trashësinë e fontit (siç është shpjeguar në rastin e shkronjës B). Këto raporte duhet të ruhen në çdo përmase që do të përdoret logo.



4. Hapësira mbrojtëse e logos është distanca që duhet të ruhet midis logos dhe elementeve të tjerë grafikë të etiketës. Kjo hapësirë është e barabartë me hapësirën jeshile brenda logos (2X).



5. Logoja duhet të ketë një lartësi 28.9 mm dhe gjerësi 30 mm. Madhësia minimale e lejuar për logon është 13 mm. Në raste të veçanta, për paketime shumë të vogla madhësia e logos mund të reduktohet në 10 mm x 9.63 mm.

6. Fondi i shkrimit DIN Next LT Pro, duhet të përdoret për përmbajtjen që mund të shoqërojë logon.

7. Nëse logoja është përdorur në sfond me ngjyrë, e cila vështirëson dallimin e saj, atëherë përdoret një linjë e bardhë kufizuese për logon, për të përmirësuar kontrastin me ngjyrën e sfondit.




8. Nëse logoja është përdorur në një sfond me ngjyrë të njëjtë, shtohet një linjë e bardhë në anësore. Ky version mund të zgjidhet për arsye estetike nëse dëshirohet shmangia e kthimit në negativ të simbolit.



9. Nëse ngjyra e sfondit të paketimit ose etiketimit është e errët, logoja mund të përdoret në format negativ, duke përdorur si ngjyrë sfondi atë të paketimit ose të etiketimi



10. Logoja mund të përdoret edhe bardhë e zi, siç tregohet më poshtë, nëse është e pamundur të aplikohet me ngjyra.



11. Kur logoja vendoset mbi një imazh duhet të përdoret një linjë e bardhë kufizuese për ta bërë atë të dukshme.



Këshillohet që të përdoren imazhe të qeta, që krijojnë kontrast me logon, si më poshtë:



12. Në rastet e veçanta, kur treguesit në paketim janë në një ngjyrë të vetme edhe logoja mund të përdoret në të njëjtën ngjyrë.

13. Më poshtë paraqiten rastet e përdorimit të gabuar të logos, të cilat duhet të shmangen:



14. Logoja mund të shoqërohet me elemente grafike ose tekst që i referohen prodhimit biologjik, me kusht që të mos modifikohet apo të ndryshohet natyra e logos apo ndonjë nga treguesit e përmendur në nenin 12, të këtij vendimi.

15. Versioni digjital i logos kombëtare për prodhimin biologjik, për printim digjital dhe shtyp, gjendet në *website*-n e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.



ANEKSI II

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
**Nr. i protokollit:
Data:**
NJOFTIMI I AKTIVITETIT NË FUSHËN E PRODHIMIT BIOLOGJIK
OPERATORI (Emri dhe NIPT-i ose karta e fermerit) _____

 Fermer/person fizik ☐ Shoqëri ☐ SHKB ☐
ADRESA E ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Qarku/ Bashkia /Njësia administrative _____

Rruga: _____, nr. _____

Kodi postal _____; tel. _____; fax _____; e-mail _____

FERMERI/ PERSONI FIZIK/ PËRFAQËSUESI LIGJOR

EMRI _____

MBIEMRI _____

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA _____ GJINIA _____

NR. PERSONAL (ID) _____

Qarku/ Bashkia /Njësia administrative _____

Rruga: _____, nr. _____

Kodi postal _____; tel. _____; fax _____; e-mail _____

TRUPA E KONTROLLIT (TK) E KONTRAKTUAR
1. Emri dhe numri kodues _____ **Aktiviteti i kontrolluar** 01 ☐ 02 ☐ 03 ☐ 04 ☐
LLOJI I AKTIVITETIT

- 01 Prodhim primar
- ☐
-
- 02 Përgatitje/përpunim
- ☐
-
- 03 Importues
- ☐
-
- 04 Eksportues
- ☐

LLOJI I NJOFTIMIT

- Regjistrimi i parë
- ☐
-
- Regjistrim i ndryshimeve
- ☐

ARSYET E NDRYSHIMEVE

 Ndryshimi të dhënave të personit
 deklarues ose përfaqësuesit ligjor ☐
 Ndryshim i njësive prodhuese ☐
 Ndryshim i kategorive të aktivitetit ☐
 Të tjera _____
 Ndryshim i Trupës së Kontrollit (TK) ☐

**PRODUKTE ME METODËN E PRODHIMIT ORGANIK****LLOJI I PRODUKTIT**

- ☐ Bime mbledhje spontane ☐ Prodhim bimor kultivim ☐ Algat e detit dhe produktet e tyre
☐ Mbarështim kafshë dhe bletari ☐ Produkte të përpunuara shtazore/bimore
☐ Ushqim për kafshë ☐ Akuakulture
☐ Të tjera (specifiko) _____

SIPËRFAQE BUJQËSORE

Sipërfaqja e përgjithshme: ha _____

Sipërfaqja bujqësore në përdorim _____ Numri i përgjithshëm i parcelave _____

Sipërfaqe:

- Në kalim _____ ha _____
 Numri _____ dhe vendndodhja e parcelave _____
 Nga këto në sera ha _____
- Organike _____ ka
 Numri _____ dhe vendndodhja e parcelave _____
 Nga këto në sera ha _____
- Konvencionale/të tjera _____ ha
 Numri _____ dhe vendndodhja e parcelave _____

Data kur ka ndërprerë përdorimin e produkteve dhe substancave të palejuara në prodhimin biologjik _____

LLOJI I PRODUKTIT ORGANIK

- Drithëra ☐
 Perime ☐
 Fruta ☐
 Vreshtari ☐
 Ullishte
 Bimë aromatike dhe mjekësore ☐
 Foragjere ☐
 Mbledhja bimësh të egra/natyrale ☐
 Përpunim:
 Prodhim bimor _____
 Prodhim shtazor _____
 Të tjera (specifiko) _____
☐ Përshkrimi i tyre _____

PRODHIM SHTAZOR – AKUAKULTURË - BLETARI

- Llojet/ speciet e kafshëve _____
 Numri _____
 Numri _____
 Numri _____
 Bletë/numri i zgjojeve _____

**DEKLARATË**

I/e nënshkruari/a _____

Fermer/person fizik ☐Përfaqësues ligjor ☐**DEKLAROJ**

Se do të kryej aktivitetin në përputhje me kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

I/e nënshkruari/a deklaroj nën përgjegjësinë personale vërtetësinë dhe tërësinë e këtij deklarimi. Për më tepër deklaroj se jam në dijeni, në rast të shkeljeve ose mosplotësimit të angazhimeve të marra, përveç se për shkaqe madhore, për zbatimin e masave ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Data: _____

(emër, mbiemër, firmë)

ANEKSI III
MODELI I CERTIFIKATËS SË OPERATORIT

Certifikata e operatorit, siç përcaktohet në nenin 35 të ligjit.	
1. Numri i dokumentit:	
2. Emri dhe adresa e operatorit: Aktiviteti kryesor (prodhues, përpunues, importues etj.):	3. Emri, adresa dhe numri kodues i trupës së kontrollit:
4. Grupet e produkteve/aktiviteti: - bimë dhe produkte bimore, - algat e detit dhe produktet e tyre - kafshë dhe produkte shtazore - ushqim për kafshë - specie nën akuakulturë dhe produktet e tyre - produkte të përpunuara	5. Përcaktuar, si: Prodhim biologjik, produkte në kalim, dhe prodhimi jobiologjik kur ndodh prodhimi / përpunimi paralel sipas nenit 11 të ligjit.
6. Periudha e vlefshmërisë: Produkte bimore nga ... deri... Produkte të algave të detit nga ... deri... Produkte shtazore nga ... deri... Produkte të akuakulturës nga ... deri... Produkte të përpunuara nga ... deri	7. Data e kontrollit/eve:
8. Ky dokument lëshohet sipas përcaktimit në nenin 35 të ligjit dhe nenit 23 të këtij vendimi. Operatori i ka nënshtruar aktivitetin e tij sistemit të kontrollit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.	
Data, vendi:	
Nënshkrimi në emër të trupës së kontrollit që lëshon dokumentin:	



ANEKSI IV
DEKLARATA E SHITËSIT

Deklarata e shitësit sipas nenit 9, pika 3 të ligjit.	
Emri, adresa e shitësit:	
Identifikimi (p.sh. numri i lotit)	Emri i produktit:
Përbërësit: (Specifikoni të gjithë përbërësit që ekzistojnë në produktin/përdoren të fundit në procesin e prodhimit.)	
Deklaroj se ky produkt nuk është prodhuar ‘nga’ as ‘me’ OMGJ, ashtu siç janë përdorur këta terma në nenet 3 dhe 9 të ligjit. Unë nuk kam ndonjë informacion që mund të cenojë saktësinë e kësaj deklarete. Deklaroj se produkti i lartpërmendur është në përputhje me nenin 9 të ligjit, lidhur me ndalimin e përdorimit të OMGJ-së. Unë marr përsipër të informoj menjëherë klientët tanë dhe trupën e kontrollit të tyre, nëse kjo deklaratë tërhiqet ose ndryshohet ose në rast se paraqitet ndonjë informacion që cenon saktësinë e saj. Autorizoj trupën e kontrollit, e cila mbikëqyr klientët tanë, të verifikojë saktësinë e kësaj deklarete dhe nëse është e nevojshme të marrë mostra për vërtetim analitik. Gjithashtu, pranoj se kjo detyrë mund të kryhet nga një institucion i pavarur që është caktuar me shkrim nga trupa e kontrollit. I nënshkruari merr përgjegjësinë për vërtetësinë e kësaj deklarete.	
Shteti, vendi, data, nënshkrimi i shitësit:	Vula e kompanisë së shitësit (nëse është e mundur):

VENDIM
Nr. 6, datë 16.12.2019

**PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË
KRIJUARA NGA TËRMETI I DATËS
26 NËNTOR**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore në qarqet e Durrësit, Lezhës dhe Tiranës, i mbledhur sot më 16.12.2019,

VENDOSI:

1. Mbetjet inerte të krijuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë të transportohen dhe të depozitohen në venddepozitim të Porto-Romanos, Bashkia Durrës.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve të marrë masat e nevojshme për inkapsulimin e zonës

së Porto-Romanos dhe rijetësimin e kësaj zone me procedurë të përsheptuar, në kushtet e emergjencës së krijuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 7, datë 18.12.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
TË ADMINISTRIMIT DHE
SHPËRNDARJES SË MALLRAVE,
NDIHMË HUMANITARE, DHURUAR
NGA DONATORË TË HUAJ ME
DESTINACION TË PËRCAKTUAR
TË NJË KOMUNITETI**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.



102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot më 18.12.2019

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për administrimin dhe shpërndarjen e mallrave, ndihmë humanitare, që vijnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur donatori ka përcaktuar shprehimisht një komunitet të caktuar si pritës të këtyre mallrave.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe strukturat lokale të mbrojtjes civile për qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës të bashkërendojnë punën për kryerjen e procedurave doganore, pritjen e mallrave dhe lëvrimit të tyre, drejtpërdrejt nga këta të fundit, në favor të komunitetit të përcaktuar nga donatori.

3. Në rast se strukturat lokale njoftohen paraprakisht nga donatori për dërgesën, pikën kufitare hyrëse dhe kohën e parashikuar të mbërritjes së mallrave me destinacion të përcaktuar, atëherë ato autorizojnë një përfaqësues, i cili paraqitet në degën doganore përkatëse për të bërë të mundur kryerjen e procedurave dhe shoqërimin e mallrave deri në destinacionin e përcaktuar.

4. Në rast se strukturat lokale nuk kanë dijeni paraprake për një dërgesë të caktuar, atëherë, menjëherë me mbërritjen e mallrave, ndihmë humanitare, në pikën kufitare, degët doganore të njoftojnë pa vonesë strukturat lokale, të cilat vijojnë të procedojnë normalisht, sipas mënyrës së parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Për garantimin e zbatimit të procedurave të këtij vendimi, çdo strukturë lokale të vërë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, së paku dy pika kontakti me qëllim koordinimin e menjëhershëm të punës.

6. Kur vlerësohet e arsyeshme, për shkak të natyrës apo vlerës së dërgesës, strukturat lokale mund të bashkëpunojnë me Drejtorinë e

Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim shoqërimin e mallrave të dhuruara nga pika kufitare deri në mbërritjen në destinacion të e përcaktuar nga donatori. Në rast se dërgesa vjen në rrugë tokësore dhe gjatë rrugës për në destinacion ndryshon njësia e ngarkuar për shoqërimin e mjeteve, atëherë përpilohet procesverbal për çdo dorëzim detyre, nga njëra njësi në tjetrën. Ky procesverbal bëhet pjesë e praktikës shkresore përfundimtare.

7. Në përfundim të lëvrimit të mallrave, në favor të komunitetit pritës, përfaqësuesi/ komisioni i ngarkuar nga strukturat lokale për të pritur dhe lëvruar mallrat harton një procesverbal ku të shënohen, sipas rastit, të dhënat e donatorit, dërgesës, lista e mallrave dhe pritësi i mallit. Procesverbali të mbahet në tri kopje, nga të cilat një kopje të qëndrojnë në strukturën lokale, një të vihet në dispozicion të donatorit dhe një t'i përcillet menjëherë degës doganore në të cilën janë kryer procedurat, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi.

8. Për rastet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të pritjes dhe lëvrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të mallrave, ndihmë humanitare, me destinacion të përcaktuar nga donatori, të përfundohen procedurat e lëvrimit me marrjen e konfirmimit nga komuniteti përfitues. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, që brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përcjellë pranë KNEC-së një relacion të detajuar për ndihmat humanitare me destinacion të përcaktuar, të lëvuara deri tani.

9. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, strukturat lokale të mbrojtjes civile për qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë